

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Sociologjisë

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Arsim dhe Lidërsip

“Efektet e pandemisë në arsimin universitar sot dhe si do të ndikojnë në të ardhmen e arsimit
universitar në Shqipëri”

Punoi: Romina Lama

Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore në Master Shkencor

Tiranë 2021

HYRJE

Në fillim të vitit 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë, njoftoi shpërthimin e një virusi të ri corona-SARS-Cov-2 në Kinë (Visbeck, 2020). Pothuajse të gjitha kolegjet dhe universitetet u zhvendosën online në pranverën e vitit 2020, për shkak të COVID-19. COVID-19 paraqet pengesa unike për kolegjet dhe universitetet. Kufizon aftësinë e tyre për të ofruar shërbime thelbësore - arsimore dhe të tjera - ndërsa garanton sigurinë e studentëve, fakultetit, stafit dhe komuniteteve përreth (Kelly & Columbus, 2020). Pedagogët dhe studentët u përballën me një gamë të gjerë të problemeve logjistike, teknike, financiare dhe sociale (Chakraborty et al., 2020). Kërkesa për arsim të lartë në të gjithë kontinentin tejkalon mundësitë e disponueshme (Daly, 2021). Përhapja e shpejtë e COVID-19, la shumë edukatorë/edukues të papërgatitur (Malkus et al., 2020). Në shumë vende, arsimtarët shpejt u zhvendosën në mësimdhënie në distancë, me shpresën për të shpëtuar vitin akademik (Felter & Maizland, 2020). Në Shqipëri pas urdhërit të Ministres së Arsimit për të ndërprerë mësimin në datën 9 mars, universitetet ndërprejnë menjëherë mësimin në auditore. Kjo ishte ndërprerja e dytë e mësimit gjatë një viti akademik pas gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019. Kjo situatë i gjeti universitetet të papërgatitura dhe të pa organizuara për të vijuar mësimin online (Qëndresa Qytetare, 2020).

Qëllimi i këtij studimi është që të analizohen efektet e pandemisë në arsimin e lartë sot dhe se si do të ndikojnë në të ardhmen e arsimit të lartë në Shqipëri. Në aspektin e vlerës njohëse dhe të rëndësisë, ky studim paraqet një ndihmesë modeste të pasqyrimin të efekteve të pandemisë në arsimin e lartë sot dhe se si do të ndikojnë në të ardhmen e arsimit të lartë në Shqipëri. Gjithashtu ky studim nxjerr në pah një fenomen aktual në shoqërinë tonë, duke shpresuar që shumë studime akoma më të mëdha të kryhen në të ardhmen përse i përket kësaj tematike.

ZHVILLIM

Padyshim që mësimi online ka shumë përfitime, por disa dobësi të tij gjithashtu mund të identifikohen, të tilla si në aspektin e shëndetit fizik. Për shkak se studentët dhe mësuesit/pedagogët kalojnë shumë orë ulur dhe para një ekrani, mund të zhvillojë probleme të shikimit ose shpinës dhe aktiviteti i tyre në natyrë/jashtë mund të zvogëlohet (Coman et al., 2020). Pandemia ka ekspozuar dobësitë dhe mangësitë e sistemeve aktuale të arsimit dhe gjithashtu ka theksuar nevojën për zhvillimin e shkrim-leximit dixhital. Ekziston një “pabarazi dixhitale” e madhe në shoqëri (Rashid & Yadav, 2020). Aksesimi në kompjuter, internet dhe teknologji, ka qenë gjithnjë i shtresëzuar - me pakicat racore dhe etnike, njerëzit me prejardhje më të ulët socio-ekonomike dhe njerëzit në zonat rurale - të cilat kanë më pak të ngjarë të kenë një kompjuter dhe lidhje interneti (Gillis & Krull, 2020). Ndërhyrja e njerëzve dhe kafshëve shtëpiake, është pamja ose ndërprerja e papritur e anëtarëve të familjes, miqve dhe kafshëve shtëpiake, që mund të shkaktojë devijim të vëmendjes së pjesëmarrësve gjatë mësimit online (Adedoyin & Soykan, 2020). Ngarkesa e madhe e punimeve online, pritet të shkaktojë kosto të paparashikuar financiare dhe kohore. Këto ngarkesa, kanë shtuar stresin e studentëve dhe kjo mund të rezultojë në probleme të shëndetit mendor (Adedoyin & Soykan, 2020). Me mësimin online, ka gjithashtu një shans më të madh që studentët të shpërqëndrohen lehtësisht nga mediat sociale ose faqet e tjera (Gautam, 2020). Në një klasë online, ka ndërveprime minimale fizike. Kjo shpesh çon në një ndjenjë izolimi tek studentët (Gautam, 2020). Studentët shqetësohen si për pandeminë në përgjithësi, ashtu edhe për karrierat e tyre. Mungesa e motivimit dhe emocionet negative, e bëjnë të vështirë për shumë studentë që të përqëndrohen në edukimin online (Chakraborty et al., 2020). Davies dhe Graff zbuluan se ndërveprimi më i madh në internet, nuk ishte i lidhur me performancë më të lartë për studentët (Ni, 2013). Pamundësia për të

bashkëvepruar lirshëm me studentët e tjerë, mund të përkeqësojë ndjenjat e vetmisë (McInnerney & Roberts, 2004). Vëzhgues të shumtë kanë parashikuar që studentët dhe familjet do të rishikojnë pse paguajnë kaq shumë për arsimim ballë për ballë, kur mund të marrin një diplomë për shumë më pak para në internet (Kelly & Columbus, 2020). Ndonjëherë studentit i duket se mësimi në internet është i mërzitshëm dhe jo-tërheqës. Ndonjëherë, përmbajtja në internet është e gjitha teorike dhe nuk i lë studentët të praktikojnë dhe të mësojnë në mënyrë efektive (Dhawan, 2020). Takimet personale dhe konferencat shkencore janë shtyrë ose konfiguruar në formate online (Visbeck, 2020). Mbetet të shihet, nëse shkollat mund të hapen përsëri në mënyrë të sigurt. Rihapja e shkollave është gjithashtu e kushtueshme (Felter & Maizland, 2020). Qeveria shqiptare publikoi Aktin Normativ Nr. 12, datë 02.04.2020, me qëllim shtyrjen e pagesave të qerasë për 2 muaj, prill dhe maj, për studentët që janë larguar për në banesat e tyre pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë. Qeveria nuk mori parasysh ankesat e studentëve dhe shoqërisë civile për të siguruar bonus qeraje për dy muaj ose disbursim të qerave nëpërmjet mospagimit të tarifave të studimit. Nga ana tjetër “Karta e Studentit” si një instrument i prodhuar për t’iu ardhur në ndihmë studentëve nëpërmjet shërbimeve dhe produkteve me çmime të reduktuara, nuk ofroi shumë mundësi dhe lehtësira për oferta dhe paketa internet (Qëndresa Qytetare, 2020). Sipas analizave të Strategjisë për Arsimin Parauniversitar në Shqipëri 2014-2020, sistemi i ri i decentralizuar i cili u aplikua për trajnimin e mësuesve, nuk mundësoi trajnimin në internet (Miço, 2019). Kjo mund të shpjegojë papërgatitjen masive të vendit tonë, përse i përket mësimi online, para pandemisë. Në Shqipëri, studentët shpesh ankohen se gjatë studimeve universitare nuk janë të përgatitur dhe të pajisur në mënyrë adekuate me njohuri praktike dhe se kryesisht programet e studimit që ata ndjekin i mundësojnë vetëm teorikisht, duke e bërë të vështirë zbatimin e teorive

të mësuara (Lumani, 2019). Mësimi online, mund ta vështirësojë akoma edhe më shumë këtë problem.

Metoda që kam përdorur në këtë studim, është metoda sasiore. Janë realizuar 200 anketat. Pyetjet e anketës janë një kombinim i pyetjeve të hapura dhe pyetjeve të mbyllura. Anketat janë realizuar online. Programi online që është përdorur për kryerjen e anketave, është programi Google Forms. Shumica e personave që kanë marrë pjesë në këtë ky studim, janë studentë të shkenave sociale (më së shumti nga sociologjia), bachelor&master, nga degë të ndryshme. Ndërsa pjesa tjetër, janë studentë të fakulteteve të tjera. Është respektuar e drejta e personave të intervistuar për të mbetur anonimë. Në realizimin e studimit, kam hasur disa kufizime: Për shkak të pamundësisë për t'i kryer anketat, drejtpërdrejtë/ballë për ballë, u detyrova t'i kryeja ato online. Është më e vështirë të sigurosh përgjigjdhënës për plotësimin e anketave kur realizohen online sesa, drejtpërdrejtë/ballë për ballë, për shkak të mungesës së kontakteve me këta persona, që mund t'i sigurosh lehtësisht në një ambient auditori. Kufizimet e këtij studimi përfshijnë gjithashtu shkallën e përgjigjes. Numri i pjesëmarrësve është një numër i vogël në krahasim me sasinë e të gjithë studentëve shqiptarë. Gjithashtu janë anketuar më së shumti studentë nga FSHS-ja, të cilët kanë më së shumti lëndë teorike, ndërkohë për studentë nga fakultete të tjera të cilët kanë lëndë praktike ose laboratorike, për ta kjo është një sfidë tepër. Një kufizim tjetër përfaqësohet nga fakti që mostra ishte jo-probabilistike. Kështu, rezultatet nuk mund të përgjithësohen për të gjithë sistemin e arsimit të lartë shqiptar.

Gjetjet

Mosha: 19 vjec- 12; 20 vjec- 28; 21 vjec- 64; 22 vjec- 64; 23 vjec- 16; 24 vjec- 4; 25 vjec- 4; 28-4; 29-4; **Gjinia:** 90% femër; 10% mashkull; **Niveli i studimeve:** 74% master; 26% bachelor; **Universiteti, fakulteti - UT:** 168; **UMT:** 12; **UPT:** 4; **UAMD:** 8; **UET:**8; **Fakulteti i Shkencave Sociale:** 160; **Fakulteti i Mjekësisë:** 20; **Fakulteti i Ekonomisë:** 8; **Fakulteti i Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban:** 4; **Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit:** 8; **Vendbanimi:** 80% qytet; 10% fshat; 10% periferi

1) Shumica e studentëve të anketuar (70%), kishin akses në mënyrë të vazhdueshme në orën e mësimi. 2) Mungesa e aksesit ishte për këto arsye: teknike 61%; mungesa e një lidhjeje interneti 26.8%; ekonomike 22%; mungesa e pajisjeve të nevojshme 22%; mungesa e platformave dhe teksteve dixhitale 12.2% dhe shkëputja e internetit 2.4%. 3) Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, shprehen se mësimi online për ta është mesatarisht efektiv 38%; ndjekur nga pak efektiv 30%; aspak efektiv 24% dhe shumë efektiv 8%. Këtu mund të vëmë re se studentët nuk janë edhe aq të kënaqur me mësimin online. 4) Shumica e studentëve të anketuar, e preferojnë mësimin që të zhvillohet në auditor, pasi e konsiderojnë të jetë më shumë efektiv sesa mësimi online (60%); ndjekur nga një pjesë e vogël e studentëve të cilët e preferojnë mësimin online (22%) dhe një pjesë akoma më e vogël e studentëve të cilët preferojnë mësimin e kombinuar në online dhe në auditor (18%). Këtu mund të shohim sesi shumica e studentëve preferon mësimin në auditor, në krahasim me atë online, pasi e konsiderojnë atë më efektiv. 5) Shumica e studentëve të anketuar, i preferojnë provimet në auditor, duke e konsideruar si metodë më efektive (46%); ndjekur nga një pjesë e studentëve të cilët i preferojnë provimet online (32%) dhe pjesa tjetër që preferojnë provimet e kombinuara, një pjesë të provimeve online dhe një pjesë të provimeve në auditor (22%). Këtu mund të vëmë re sesi shumica e studentëve preferojnë

provimet në auditor, duke e konsideruar si metodë më efektive, në krahasim me atë online.

6) Shumica e studentëve të anketuar, e ndjekin mësimin me celular (96%); i ndjekur nga laptopi (22%); kompjuteri (8%) dhe tableti (2%). Këtu mund të shohim se shumica e studentëve të anketuar, nuk kanë mjetet e nevojshme për të aksesuar mësimin online, shumica akoma mbështetet tek celulari. **7)** Shumica e studentëve të anketuar, shprehen se mësimi online është një praktikë e panjohur më parë për ta, pra nuk e kanë përdorur më parë si metodë (88%); ndërsa vetëm një pjesë shumë e vogël (12%), e kanë përdorur më parë si metodë. Këtu mund të vëmë re sesi shumica e fakulteteve/universiteteve në Shqipëri, sidomos ato publike, nuk e kanë përdorur asnjëherë më parë metodën e mësimit online për t'i përgatitur studentët që të marrin dije shtesë përtej auditorit. **8)** Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, shprehen se pjesëmarrja në seminare dhe leksione nuk ka ndryshuar 56%; ndjekur nga ulje e pjesëmarrjes 36% dhe rritje e pjesëmarrjes 8%. Këtu mund të shohim se mësimi online, nuk u ka ofruar mundësi studentëve që të rrisin pjesëmarrjen e tyre në mësim, duke i ofruar më shumë liri ose më pak kufizime. **9)** Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, shprehen se ka ndonjëherë (50%) mosrespektim oraresh nga ana e pedagogëve të tyre; ndjekur nga shpesh 24%; asnjëherë 20% dhe gjithmonë 6%. Këtu mund të vëmë re një fare abuzimi me orarin, për shkak të fleksibilitetit të mësimit online. **10)** Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, shprehen se niveli i komunikimit me pedagogët e tyre ka mbetur njësoj gjatë mësimit online, në krahasim me komunikimin në auditor (46%); ndjekur nga ulja e nivelit të komunikimit me pedagogët gjatë mësimit online 34% dhe rritja e nivelit të komunikimit me pedagogët gjatë mësimit online 20%. Këtu mund të shohim se mësimi online nuk ka çuar në rritje në nivelin e komunikimit studentë-pedagogë. **11)** Shumica e studentëve të anketuar, shprehen se karta e studentit nuk u ka sjellë asnjë minimizim kostosh në blerjen e internetit apo pajisjeve elektronike 76%; ndjekur nga nuk e di/pa përgjigje 24% dhe po, karta e

studentit ka rritur mundësinë për të aksesuar mësimin online 0%. Këtu mund të vëmë re sesi karta e studentit, është pothuajse inekzistente dhe nuk kryen pothuajse asnjë funksion për studentët, kur në fakt ajo duhet të kryejë funksione të shumta. **12)**Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, shprehen se kanë një hapësirë të qetë në shtëpi për të ndjekur mësimin online ndonjëherë 46%; ndjekur nga shpesh 36%; asnjëherë 10% dhe gjithmonë 8%. **13)**Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, shprehen se interneti ju kushton mesatarisht për një muaj përdorim, për zhvillimin e mësimin online (e shprehur në lekë të reja) 1500-2000 44%; e ndjekur nga 1000-1500 28%; 2000-3000 14%; mbi 3000 8%; 1000 6%; dhe më pak se 1000 (0%). Këtu mund të shohim se studentët shpenzojnë një shumë të konsiderueshme për internetin çdo muaj dhe kjo i rëndon xhepat e studentëve shqiptarë. **14)**Shumica e studentëve të anketuar, shprehen se në kushtet e mësimin online, nuk kanë kursyer para, për shkak se gjithsesi do të paguajnë për tarifën e shkollës, librat, internet&pajisje teknologjike 68%; ndërsa pjesa tjetër shprehet se ka kursyer para, duke mos patur disa shpenzime si psh: konvikt/qera, abone/bileta etj 32%. Këtu mund të vëmë re se mësimi online në fakt nuk ka kursyer para, por është pak a shumë njësoj sikur të jesh në auditor, për shkak se shpenzimet kryesore përsëri do të kryhen. **15)**Pothuajse të gjithë studentët e anketuar (90%), shprehen se ju mungon auditori dhe miqtë. Këtu mund të shohim ndjesinë e izolimit social që ndjejnë studentët të mbyllur në shtëpi përpara ekranit. **16)**Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, shprehen se ndonjëherë 54% kanë vështirësi të fokusohen në ekranet e kompjuterit/laptopit/tabletit/celularit (shpërqëndrohen shpesh); ndjekur nga shpesh 38%; gjithmonë 8% dhe asnjëherë 0%. **17)**Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, janë dakord (40%) që koha e tepërt në ekran po shkakton stres/ankth, po ndikon në gjumë dhe në rritjen e problemeve shëndetësore; ndjekur nga shumë dakord 32%; pak a shumë/pjesërisht dakord 24% dhe aspak dakord 4%. **18)**Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, janë dakord (38%) që

vlerësimi online krijon më shumë ankth sesa format tradicionale të vlerësimit; ndjekur nga pak a shumë/pjesërisht dakord 30%; shumë dakord 26%; aspak dakord 6%. **19)**Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar, nuk janë aspak dakord 52% se mësimi online, i ndihmon më mirë që të kuptojnë materialet e kursit, krahasuar me mësimin në auditor; ndjekur nga pak a shumë/pjesërisht dakord 38%; dakord 8% dhe shumë dakord 2%. **20)**Pjesa më e madhe e studentëve të anketuar janë dakord (38%) që kalojnë më shumë kohë/janë më të mbingarkuar me detyrat/projektet në mësimin online dhe kanë më pak kohë t'i zgjidhin ato, në krahasim me mësimin në auditor; ndjekur nga shumë dakord 32%; pak a shumë/pjesërisht dakord 24% dhe aspak dakord 6%. Këtu mund të vëmë re se mësimi online nuk i lehtëson studentët dhe ata nuk kanë më shumë kohë të lirë sesa në auditor për shkak se ndodhen në shtëpi, por po ndodh krejt e kundërta, studentët po mbingarkohen më shumë gjatë mësimin online. **21)**Shumica e studentëve të anketuar, shprehen se sfida kryesore që hasnin më shumë në zhvillimin e mësimin online, është vështirësia në përqëndrim gjatë kohës që zhvillohet mësimi online 70%; ndjekur nga mbingarkesë detyrash dhe materialesh 66%; aksesin në internet 56%; linjë e dobët interneti 54%; izolimi në shtëpi 46%; kosto e përdorimit të internetit 38%; problemet fizike/shëndetësore dhe psikologjike nga qëndrimi i zgjatur në ekran dhe në shtëpi 36%; pasja e një metodologjie për këtë lloj mësimdhënie 30%; orar i papërshtatshëm i zhvillimit të mësimin online 30%; sigurimi i platformave të duhura 24% dhe mjetet që e mundësojnë aksesin në mësim 20%. **22)**Shumica e studentëve të anketuar, shprehen se duhen bërë ndryshime në infrastrukturën fizike 62%; ndjekur nga materialet dixhitale 58%; në kapacitetet e pedagogëve 30%; në kapacitetet e studentëve 28% dhe të kishite oferta me kosto më të ulët për studentët, për akses në internet 2%.

PËRFUNDIME

Kur ende nuk dihet e ardhmja e arsimit të lartë, ajo që mund të thuhet me siguri është se studentët po gjenden në vëshirësi. U kuptua nga të gjithë që teknologjia dhe interneti janë një domosdoshmëri në këtë periudhë që ndodhemi. Ekziston një ndarje dixhitale, e cila mund të zgjerojë boshllëqet e pabarazisë. Përmes karakteristikave dhe veçorive të tij, mësimi online mund të përmirësojë procesin e mësimin, por në mënyrë që të ndikojë pozitivisht në performancë, pedagogët dhe studentët, duhet të dinë se si ta integrojnë atë në mënyrë efektive në procesin e mësimdhënies. Disponueshmëria e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe mbulimi dhe shpejtësia e internetit, janë thelbësore. Për një vend në zhvillim si Shqipëria, kufizimet teknike, përshtatshmëria e pajisjeve teknologjike, disponueshmëria e internetit, pamundësia ekonomike, mungesa e trajnimit të mësimin online dhe mungesa e një metodologjie të mësimdhënies online, përbëjnë një sfidë serioze. Le të shpresojmë që me uljen e rasteve dhe vdekjeve nga COVID-19 dhe me qarkullimin e vaksinave, studentët, pedagogët dhe stafi akademik të mund të rikthehen në auditore, në mënyrë që jeta universitare të rikthehet në normalitet.

REKOMANDIME

Nga analiza e bërë, mendoj se ka vend për shumë përmirësime. Duhet të bëhet trajnimi i duhur i arsimtarëve për aftësitë dixhitale dhe për ndërveprimin e përmirësuar student-pedagog. Për studentët në disavantazh, duhet të sigurohet disponueshmëria e infrastrukturës dixhitale me disponueshmërinë e duhur të internetit dhe aksesin në pajisjet. Kjo mund të bëhet nëpërmjet dhurimit të tabletëve ose laptopëve/kompjuterëve, për të ndjekur mësimin online dhe bashkëpunimit me kompanitë që ofrojnë shërbim interneti, për të mbuluar një pjesë të kostos së internetit nga shteti. Për shkak të situatës, shumë studentë ka të ngjarë të vuajnë nga stresi, ankthi dhe depresioni, prandaj është e nevojshme të sigurohet mbështetje emocionale për studentët. Duhet gjithashtu të rishikohen metodat e vlerësimit, të cilat mund të jenë më fleksible se ato tradicionale. Universitetet duhet të përgatisin metodologji të re të vlerësimit. Është e domosdoshme që pedagogët të mbajnë orët e tyre online dinamike, interesante, të freskëta, tërheqëse dhe interaktive, për t'i ndihmuar studentët të qëndrojnë të përqëndruar në mësim dhe që të zvogëlojnë ndjenjën e izolimit. Është e rëndësishme që shkollat të investojnë në trajnimin e mësuesve me përditësimet më të fundit të teknologjisë, në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë klasat e tyre online pa probleme. Duhet që studentëve t'i jepen shpesh pushime nga ekrani, për të rifreskuar mendjen dhe trupin e tyre. Cilësia e kurseve duhet të përmirësohet vazhdimisht dhe pedagogët dhe studentët duhet të përpiqen të japin më të mirën e tyre.

- **Shënim:** Tek llogaritja e fjalëve të lejuara të punimit, nuk është përfshirë faqja e parë (kapaku), bibliografia dhe shtojcat.

BIBLIOGRAFIA

Adedoyin, B. O., & Soykan. (2020). *Covid-19 pandemic and online learning: the challenges and opportunities*. Retrieved June 3, 2021, from

<https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/10494820.2020.1813180>

Chakraborty, P., Mittal, P., Gupta, M. S., Yadav, S., Arora, A. (2020). *Opinion of students on online education during the COVID-19 pandemic*. Retrieved June 3, 2021, from

<https://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1002/hbe2.240>

Coman, C., Tiru L. G., Mesesan-Schmitz, L., Stanciu C., Bularca C. M. (2020). *Online Teaching and Learning in Higher Education during the Coronavirus Pandemic: Students' Perspective*.

Retrieved June 3, 2021, from <https://www.mdpi.com/2071-1050/12/24/10367/pdf>

Daly, S., & Institute for Defense Analyses. (2021). *AFRICA WATCH: COVID-19 Edition* (pp. 5-7, Rep.). Institute for Defense Analyses. Retrieved June 3, 2021, from

<http://www.jstor.org/stable/resrep29557.4>

Dhawan, S. (2020). *Journal of Educational Technology Systems. Online Learning: A Panacea in the Time of COVID-19 Crisis*. Retrieved June 3, 2021, from

<https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/0047239520934018>

Felter, C., & Maizland, L. (2020). (Rep.). Council on Foreign Relations. Retrieved June 3, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/resrep29837>

Gautam, P. (2020). *Advantages And Disadvantages Of Online Learning*. Retrieved June 3, 2021, from <https://elearningindustry.com/advantages-and-disadvantages-online-learning>

Gillis, A., & Krull, M. L. (2020). Teaching Sociology. *COVID-19 Remote Learning Transition in Spring 2020: Class Structures, Student Perceptions, and Inequality in College Courses*.

Retrieved June 3, 2021, from <https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/0092055X20954263>

Kelly, A., & Columbus, R. (2020). (Rep.). American Enterprise Institute. Retrieved June 3, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/resrep25358>

Lumani, M. (2019). Teaching Practice in the Albanian Context: Student-Teachers' Perceptions regarding their Experience in Teaching. (pp. 168-183). Retrieved June 3, 2021, from https://www.jstor.org/stable/pdf/j.ctvpb3xhh.15.pdf?ab_segments=0%252Fbasic_search_gsv2%252Fcontrol&refreqid=excelsior%3Acd1f6e69e2d6efe335ccfcad8d80f7c9

Malkus, N., Christensen, C., & Schurz, J. (2020). (Rep.). American Enterprise Institute. Retrieved June 3, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/resrep25360>

McInnerney, M. J., & Roberts, S. T. (2004). Online Learning: Social Interaction and the Creation of a Sense of Community. *Journal of Educational Technology & Society*, 7(3), 73-81. Retrieved June 4, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/jeductechsoci.7.3.73>

Miço, H. (2019). The Teaching Profession in Albania and the Continuous Need for Improvement through Teacher Training Reforms. (pp. 150-167). Retrieved June 3, 2021, from https://www.jstor.org/stable/pdf/j.ctvpb3xhh.14.pdf?ab_segments=0%252Fbasic_search_gsv2%252Fcontrol&refreqid=excelsior%3A3e3bf5e553d29bd882849a2c2ccc3d67

Ni, A. (2013). Comparing the Effectiveness of Classroom and Online Learning: Teaching Research Methods. *Journal of Public Affairs Education*, 19(2), 199-215. Retrieved June 4, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/23608947>

Qëndresa Qytetare. (2020). *Vlerësimi i situatës së arsimit të lartë nën ndikimin e COVID-19*.

Retrieved June 3, 2021, from <https://qq.com.al/wp-content/uploads/2020/04/Vleresim-i-Studenteve-16-04-2020-fianl-1.pdf>

Rashid, S., & Yadav, S. S. (2020). Indian Journal of Human Development. *Impact of Covid-19 Pandemic on Higher Education and Research*. Retrieved June 3, 2021, from

<https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/0973703020946700>

Visbeck, M. (2020). Ocean Science During the Corona Virus Pandemic: CHALLENGES AND OPPORTUNITIES. *Oceanography*, 33(2), 6-7. Retrieved June 3, 2021, from

<https://www.jstor.org/stable/26937731>

Shtojcat

Mosha

Gjinia: femër; mashkull

Niveli i studimeve: master; bachelor

Universiteti, fakulteti dhe dega e studimit

Vendbanimi: qytet; fshat; periferi

1. A keni akses në mënyrë të vazhdueshme në orën e mësimi?

po; jo

2. Mungesa e aksesit është për çfarë arsye?

teknike; mungesa e një lidhjeje interneti; ekonomike; mungesa e pajisjeve të nevojshme;
mungesa e platformave dhe teksteve dixhitale; shkëputja e internetit

3. Sa efektiv është mësimi online në raport me mësimin tradicional të zhvilluar në fakultet?

mesatarisht efektiv; pak efektiv; aspak efektiv; shumë efektiv

4. Mësimin e preferoni?

në auditor; online; të kombinuar

5. Provimet i preferoni?

në auditor; online; të kombinuar

6. Me çfarë mjeti e ndiqni mësimin? Mund të klikoni në disa opsione.

celular; laptop; kompjuter; tablet

7. Mësimi online është një praktikë e panjohur më parë për ju, apo fakulteti/universiteti/shkolla juaj e ka aplikuar si metodë më përpara pandemisë, në mënyrë për t'i orientuar studentët që të marrin dije shtesë përtej auditorit?

jo nuk e kam përdorur më parë si metodë; po e kam përdorur më parë si metodë

8. A ka ndikuar mësimi online në pjesëmarrjen tuaj?

jo, pjesëmarrja ime nuk ka ndryshuar; po, pjesëmarrja ime është ulur; po, pjesëmarrja ime është rritur

9. A ka mosrespektim oraresh nga ana e pedagogëve tuaj?

ndonjëherë; shpesh; asnjëherë; gjithmonë

10. Si është niveli i komunikimit me pedagogët tuaj online, në krahasim me komunikimin në auditor?

niveli i komunikimit me pedagogët ka mbetur njësoj gjatë mësimin online; niveli i komunikimit me pedagogët është ulur gjatë mësimin online; niveli i komunikimit me pedagogët është rritur gjatë mësimin online

11. A ju është siguruar ndonjë ulje kostosh nga Karta e Studentit?

jo, karta e studentit nuk më ka sjellë asnjë minimizim kostosh në blerjen e internetit apo pajisjeve elektronike; nuk e di pa përgjigje; po, karta e studentit ka rritur mundësinë time për të aksesuar mësimin online

12. A keni një hapësirë të qetë në shtëpi për të ndjekur mësimin online?

ndonjëherë; shpesh; asnjëherë; gjithmonë

13. Sa ju kushton mesatarisht interneti/sa shpenzime kryeni për internetin për një muaj përdorim, për zhvillimin e mësimit online (e shprehur në lekë të reja)?

1500-2000; 1000-1500; 2000-3000; mbi 3000; 1000; më pak se 1000

14. Në kushtet e mësimit online, a ndjeni sikur keni kursyer para, apo ka ndodhur e kundërta?

nuk kam kursyer para, për shkak se gjithsesi do paguaj për tarifën e shkollës, librat fotokopje, internet&pajisje teknologjike; kam kursyer para, duke mos patur disa shpenzime si psh: konvikt/qera, abone/bileta/rruga etj.

15. A ju mungon auditori dhe miqtë?

po; jo

16. A keni vështirësi të fokusoheni në ekranet e kompjuterit/laptopit/tabletit/celularit – a shpërqëndroheni shpesh?

ndonjëherë; shpesh; gjithmonë; asnjëherë

17. Koha e tepërt në ekran po shkakton stres/ankth, po ndikon në gjumë dhe në rritjen e problemeve shëndetësore.

dakord; shumë dakord; pak a shumë/pjesërisht dakord; aspak dakord

18. Vlerësimi online krijon më shumë ankth sesa format tradicionale të vlerësimit.

dakord; pak a shumë/pjesërisht dakord; shumë dakord; aspak dakord

19. Mësimi online më ndihmon më mirë/shumë të kuptoj materialet e kursit, krahasuar me mësimin në auditor.

aspak dakord; pak a shumë/pjesërisht dakord; dakord; shumë dakord

20. Unë kaloj më shumë kohë/jam më e mbingarkuar me detyrat/projektet në mësimin online dhe kam më pak kohë t'i zgjidh ato, në krahasim me mësimin në auditor.

dakord; shumë dakord; pak a shumë/pjesërisht dakord; aspak dakord

21. Cilat janë sfidat kryesore të cilat hasni në zhvillimin e mësimit online? Mund të klikoni në disa opsione.

vështirësia në përqendrim gjatë kohës që zhvillohet mësimi online; mbingarkesë detyrash dhe materialesh; aksesimi në internet; linjë e dobët interneti; izolimi në shtëpi; kosto e përdorimit të internetit; problemet fizike/shëndetësore dhe psikologjike nga qëndrimi i zgjatur në ekran dhe në shtëpi; pasja e një metodologjie për këtë lloj mësimdhënie; orar i papërshtatshëm i zhvillimit të mësimit online; sigurimi i platformave të duhura; mjetet që e mundësojnë aksesin në mësim

22. Çfarë do të donit të ndryshonte në mësimin online? Mund të klikoni në disa opsione.

duhen bërë ndryshime në infrastrukturën fizike; në materialet dixhitale; në kapacitetet e pedagogëve; në kapacitetet e studentëve; të kishte oferta me kosto më të ulët për studentët, për akses në internet